



---

# Rregullore për Mbrojtjen e Fëmijës

**Janar 2021**

**(rishikimi i radhës do të ndodhë në janar 2022)**

## Përmbajtja

<b>Rregullore për Mbrojtjen e Fëmijës</b>	<b>1</b>
<b>Hyrje</b>	<b>4</b>
<b>Deklaratë mbi Rregulloren</b>	<b>5</b>
<b>Problemi për tu adresuar</b>	<b>5</b>
<b>Përkufizimet</b>	<b>5</b>
<b>Mbrojtja e fëmijës</b>	<b>5</b>
<b>Përkufizimi i fëmijës/ të riut</b>	<b>6</b>
<b>Abuzimi</b>	<b>6</b>
1. <i>Braktisja ose Mospërfillja</i>	<b>6</b>
2. <i>Abuzimi Fizik</i>	<b>6</b>
3. <i>Abuzimi seksual</i>	<b>6</b>
4. <i>Abuzimi emocional</i>	<b>6</b>
<b>Masat e ndërmarra në TOKA për ta parandaluar / menaxhuar rrezikun</b>	<b>6</b>
1. <b>Vlerësimi i riskut/ Ulja e riskut</b>	<b>6</b>
2. <b>Rekrutim i sigurt</b>	<b>7</b>
3. <b>Rregullat e sjelljes/ Kodi i sjelljes</b>	<b>8</b>
4. <b>Edukimi/ Trajnimi</b>	<b>8</b>
5. <b>Zhvillimi i programit të sigurtë</b>	<b>8</b>
6. <b>Komunikimi dhe kontakti privat me pjesëmarrës</b>	<b>8</b>
7. <b>Përgjegjësitë e stafit menaxhues</b>	<b>9</b>
8. <b>Implementimi dhe rishqyrtimi</b>	<b>9</b>
9. <b>Të dhënat e prindit dhe leja për pjesëmarrje</b>	<b>9</b>
<b>Siguria në internet</b>	<b>10</b>
1. <b>Rregullat themelore të organizatës:</b>	<b>10</b>
2. <b>Llojet e abuzimit në internet</b>	<b>10</b>
3. <b>Shenjat identifikuese</b>	<b>10</b>
4. <b>Menaxhimi i situatës</b>	<b>11</b>
<b>Procedura e raportimit dhe menaxhimit të rasteve</b>	<b>11</b>
<b>Ilustrimi i Procedurës së Raportimit</b>	<b>12</b>
<b>Kodi i Sjelljes</b>	<b>12</b>
<b>Zyrtari për Mbrojtjen e Fëmijës (Safeguarding Officer) - Jehona Gjurgjeala</b>	<b>13</b>
<b>Çka duhet Të Bëni / Të Mos Bëni kur një i ri vendos të flasë mbi abuzimin</b>	<b>15</b>
<b>Formulari për Mbrojtjen e Fëmijës</b>	<b>16</b>
<b>Zyrtari për Mbrojtjen e Fëmijës</b>	<b>17</b>
<b>Kontakte dhe Burime</b>	<b>18</b>
<b>Konfirmim i leximit dhe dakordimit</b>	<b>19</b>

# TOKA

## Rregullore për Mbrojtjen e Fëmijës

---

### Hyrje

Rregullorja e TOKA--s për Mbrojtjen e Fëmijës është përpiluar me qëllim që tu ofrojë siguri dhe mbrojtje të gjitha palëve pjesëmarrëse në programet tona, duke përfshirë stafin, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të tjerët që janë në kontakt me të rinjtë përmes TOKA--s, në mënyrë që të rinjtë të ndihen të lirë t'i zbulojnë pasionet e tyre, tërrisin vetëbesimin, dhe të zhvillojnë talente e shkathtësi që të bëhen agjentë të ndryshimit pozitiv shoqëror.

Synimet e kësaj rregulloreje janë:

- Të parandalohet abuzimi dhe të mbrohen të rinjtë.
- Të mbrohen stafi, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të tjerët që janë në kontakt me të rinjtë, përmes TOKA--s.
- Të mbrohet organizata dhe njohja e saj si organizatë që mbron të rinjtë.

Në TOKA jemi të përkushtuar të mbrojmë të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pa marrë parasysh shkathtësitë, etninë, besimin, gjininë, orientimin seksual dhe kulturën, në mënyrë që të gjithë fëmijët:

- Të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e abuzimit gjatë pjesëmarrjes në programet e TOKA--s.
- Të kenë eksperiencë pozitive dhe transformuese në programet e TOKA--s në një mjedis të sigurt, argëtues, edukativ dhe me fëmijë në qendër.

Stafi, praktikantët, vullnetarët dhe të tjerët që janë në kontakt me të rinjtë e TOKA--s, kanë përgjegjësi ta kuptojnë tërësisht dhe qartë Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijës si dhe të ngrisin vetëdijesim mbi llojet e abuzimit, parandalimit, mbrojtjes dhe procedurave të raportimit, përmes trajnimeve që do të mbahen vazhdimisht dhe përmes materialeve të disponueshme mbi këtë rregullore (trajnimeve të vazhdueshme dhe materialeve në gjuhën lokale të lidhura me këtë Politikë).

Ne presim që i gjithë stafi ynë, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të tjerët, të promovojnë sjellje të mira duke qenë shembuj të shkëlqyeshëm, duke kontribuar në diskutime të ndryshme rreth mbrojtjes së të rinjve, si dhe duke përfshirë në mënyrë pozitive njerëz që të zhvillojnë praktika të sigurta që parandalojnë dhe mbrojnë të rinjtë nga të gjitha format e abuzimit. Ne do t'i mbrojmë fëmijët në këto mënyra:

1. Duke përpiluar, implementuar dhe inkurajuar **procedura rigoroze dhe të kujdesshme për rekrutime të sigurta** dhe përzgjedhje të stafit dhe vullnetarëve, duke përfshirë ekzaminim të CV--ve, vlerësim në intervista dhe qendra vlerësuese, si dhe konfirmim nga autoritetet gjyqësore që vërteton se kandidatët nuk kanë kryer ndonjë veprë penale si

- dhe nuk janë nën hetime.
2. Duke siguruar **mbikëqyrje efektive menaxhuese** për stafin, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të tjerët duke i përkrahur, trajnuar dhe drejtuar ata. Gjithashtu, duke mbajtur trajnime të vazhdueshme dhe tërësore që edukatorët të mësojnë më shumë mbi ndihmën e parë, rregullat e sigurisë si dhe shkathtësitë pedagogjike (të përfshira edhe njohja dhe parandalimi i abuzimit dhe ngacmimit, si dhe njohja me procedurat e raportimit).
  3. **Duke raportuar për çdo shqetësim, dyshim apo dëshmi të palët që duhet të jenë të informuara** dhe duke përfshirë prindërit dhe fëmijët në mënyrë të përshtatshme, gjithashtu profesionistë dhe institucione përkatëse që kanë për detyrë të garantojnë mbrojtje.
  4. **Duke rënë dakord për të vendosur rregulla dhe pritshmëri të përbashkëta** në programet tona të cilat janë të caktuara në normën për “Vlerësim të Edukatorit” si dhe në kornizën për “Vlerësim të Performancës së Punëtorit”.
  5. **Duke formuar ekipet e TOKA--s në atë mënyrë që të parandalohen mundësitë për abuzim dhe të sigurohet raportim në kohë të duhur për raste të dyshimta ose të dëshmuara të abuzimit--** duke përfshirë udhëheqje dhe udhëzime rigorozë në atë se çfarë duhet dhe nuk duhet bërë gjatë punës me të rinjtë, për shembull: punë të edukatorëve në çifte, ose punë gjithmonë në afërsi me kolegët tjerë, në rreze dëgjimi dhe shikimi.

## Deklaratë mbi Rregulloren

Rregullorja e TOKA--s për Mbrojtjen e Fëmijës tregon përkushtimin tonë për ta parandaluar abuzimin e fëmijëve dhe për t'i mbrojtur ata nga të gjitha format e tij, për ta promovuar shëndetin, zhvillimin dhe mirëqenien e rinisë si dhe për të krijuar mjedis të sigurt ku të rinjtë mund të mësojnë dhe zhvillojnë shkathtësi të ndryshme dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë, në një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Duke fuqizuar përkushtimin që kemi ndaj mbrojtjes së të rinjve, ne do ta përmbushim qëllimin e misionit tonë për t'i pajisur ata me mundësi dhe shkathtësi për tu bërë agjentë të ndryshimit pozitiv shoqëror.

## Problemi për tu adresuar

Është rregull i TOKA--s që ta mbrojë mirëqenien e të gjithë fëmijëve dhe rinisë duke i mbrojtur ata nga të gjitha format e abuzimit, **nga braktisja apo mospërfillja, abuzimi fizik, emocional dhe seksual**. Ne përpiqemi të sigurojmë programe zhvillimore të duhura dhe kuptimplote për rininë dhe komunitetin, në mënyrë që të krijojmë mjedis të sigurt në të cilin të rinjtë të ndihen rehat dhe të pa rrezikuar gjatë angazhimit në programet tona. U kushtojmë vëmendje veçanërisht të rinjve që vijnë nga grupet e marginalizuara (vajzat, minoritetet etnike, fëmijët nga pjesët rurale etj.) që të sigurohemi sekanë përkrahje të mjaftueshme dhe trajtohen me respekt dhe barazi karshi shokëve/shoqeve tjera, gjithashtu që të sigurohemi që eksperiencat e këtyre grupeve në programet e TOKA--s të jetë e sigurt, të ndihmojë në zhvillimin personal të tyre dhe në rritjen e vetëbesimit.

# Përkufizimet

## Mbrojtja e fëmijës

Futja e praktikave dhe përfshirja e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijës në tërë organizatën për të siguruar mbrojtje të fëmijës nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi dhe mospërfillja, kudo që të jetë e mundur. Për të mbrojtur fëmijën, është e nevojshme të ketë njohuri mbi përkufizimin e fëmijës, abuzimit dhe formave të tij.

## Përkufizimi i fëmijës/ të riut

Sipas definicionit të Kombeve të Bashkuara, fëmijë është personi nën moshën 18 vjeçare, ndërsa termi i/e ri/re i referohet personit në moshën mes 15 dhe 24 vjeç.

## Abuzimi

Sipas përkufizimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) abuzime të fëmijës janë të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimi seksual, braktisja apo mospërfillja, shfrytëzimi komercial ose i çfarëdo lloji tjetër, që çon në dëm potencial apo të vërtetë të shëndetit të fëmijës, mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit, në kontekst të një lidhjeje me përgjegjësi, besim dhe fuqi. Abuzimi mund të ketë disa forma, duke përfshirë mirëpo duke mos u limituar në ato që përmenden më poshtë:

### **1. Braktisja ose Mospërfillja**

Përfshin por nuk limitohet në dështim për të mbrojtur fëmijun nga ekspozimi ndaj rrezikut, që çon në dëmtim serioz të shëndetit dhe zhvillimit të fëmijës.

### **2. Abuzimi Fizik**

Duke përfshirë mirëpo duke mos u limituar në: goditje, tundje, hedhje, helmim, djegie apo përvëlhim, përmbytje, bllokim të frymëmarrjes, ose mënyra tjera fizike të keqtrajtimit të fëmijës. Keqtrajtim fizik mund të shkaktohet gjithashtu kur një prind, autoritet prindërorapo kujdestar qëllimisht i shkakton dhimbje dhe e sëmure fëmijën.

### **3. Abuzimi seksual**

Duke përfshirë mirëpo duke mos u limituar nëveprimet në vijim. Detyrimi me forcë ose joshja e fëmijës të marrë pjesë në akte seksuale, duke përfshirë prostitucionin, edhe nëse fëmija është apo nuk është i vetëdijshëm për aktin e kryer. Veprimet mund të përfshijnë kontakte fizike, akte penetruese (p.sh. përdhunim, seks oral apo anal) dhe akte jo--penetruese. Ndër to mund të jenë aktivitete pa kontakt si detyrimi i fëmijës në shikimin, apo prodhimin e fotografive seksuale online, shikimi i akteve seksuale, ose inkurajimi i fëmijës të sillet në mënyra të papërshtatshme.

### **4. Abuzimi emocional**

Duke përfshirë mirëpo duke mos u limituar në keqtrajtim emocional të vazhdueshëm të fëmijës,që pastaj shkakton efekte armiqësore të përhershme në zhvillimin emocional të tij. Mund të përfshijë trajtimin e fëmijës si të pa vlerë dhe pa meritore të dashurisë. Gjithashtu, mund ta bëjë fëmijën të ndihet i pamjaftueshëm ose ta vlerësojë vetëm atëherë kur fëmija t'i plotësojë nevojat e një personi tjetër. Mund të përmbajë pritshmëritë moshës apo pritshmëri të papërshtatshme zhvillimi të imponuara mbi fëmijën. Abuzimi emocional i fëmijës mund të jetë i lidhur me të gjitha llojet e keqtrajtimit të tij, edhepse mund të paraqitet edhe si i vetëm.

# Masat e ndërmarra në TOKA për ta parandaluar / menaxhuar rrezikun

## 1. Vlerësimi i riskut/ Ulja e riskut

- RISKU: Menaxho riskun **duke punuar në proporcion 1 edukator/udhëheqës me 7 fëmijë(1:7)**. Ky proporcion garanton sigurinë dhe kujdesin e duhur të pjesëmarrësve/ të rinjve. Këtu përfshihet gjithashtu puna e edukatorëve në çifte apo distancë në rreze syri të kolegëve tjerë.
- RISKU: **Rregulla dhe pritshmëri të qarta dhe të përbashkëta** janë vendosur për stafin, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të rinjtë e TOKA--s. Të rinjtë do të kenë gjithashtu mundësi të punojnë së bashku në vendosjen e pritshmërive dhe rregullave në mënyrë që të sigurohet zotërim dhe respektim i dyanshëm i tyre.
- RISKU: **Shqetësimet e ngritura nga persona tjerë të stafit, nga prindër ose palë tjera shqyrtohen me seriozitet** si dhe ndërmerren hapa të caktuar (të paraqitur në faqe 7, Raportimi/ Reagimi ndaj Shqetësimeve) për ta kuptuar situatën dhe për tu sjellë siç duhet.
- RISKU: **Menaxhmenti është në dispozicion për t'i ofruar ndihmë anëtarëve të stafit kur ata të ndihen të mbingarkuar** sepse kanë nevojë për ndihmë.

## 2. Rekrutim i sigurt

- REKRUTIMI: **Aplikacionet e stafit kalojnë nëpër një proces të detajuar të përzgjedhjes**, ku kandidatët do të përzgjedhen vetëm pasi të kenë marrë pjesë në simulime praktike dhe intervista. Ky proces do të përfshijë ekzaminim të CV--së, rishikim dhe kontrollim të referencave nga punëdhënësit e mëhershëm, vlerësim në intervistë si dhe nga Qendra Vlerësuese, nënshkrim të Rregullores së TOKA--s për Mbrojtjen e Fëmijës dhe konfirmim nga autoritetet gjyqësore që vërteton se kandidatët nuk kanë kryer ndonjë vepër penale dhe nuk janë nën hetime. Paketa kontraktuale përfshin:
  - Kontratën e nënshkruar
  - Politikat Organizative të TOKA--s
  - Marrëveshjen e Konfidencialitetit
  - Deklarata e Mirëkuptimit mbi Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve e nënshkruar
  - Prova që nuk jeni nën hetime, apo i/e denuar për vepër penale
  - Kopje e pasaportës/dokumentit identifikues
  - Informatat mbi xhirollogarinë bankare
- REKRUTIMI: **Vullnetarëve nën moshën 18 vjeçare u kërkohet ta kenë lejen e prindit, të nënshkruar**, formën mjekësore, si dhe njohuri mbindonjë rrezik që lidhet me aktivitetin. Stafi ynë do të trajtohet vazhdimisht se si të sillet me vullnetarë nën moshën 18 vjeçare.
- REKRUTIMI: **Vullnetarët dhe praktikantët mbi moshën 18 vjeçare do të kalojnë nëpër një proces të detajuar të përzgjedhjes**, duke përfshirë aplikacionin, ekzaminimin e CV--së, intervistën, vlerësimin e qëllimeve, nënshkrimin e Rregullores së TOKA--s për Mbrojtjen e Fëmijës si dhe konfirmimin nga autoritetet gjyqësore që vërteton se kandidatët nuk kanë kryer ndonjë vepër penale dhe nuk janë nën hetime. Paketa kontraktuale përfshin:

- o Kontratën e nënshkruar
  - o Politikat Organizative të TOKA--s
  - o Marrëveshjen e Konfidencialiteti
  - o Deklarata e Mirëkuptimit mbi Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve e nënshkruar
  - o Prova që nuk jeni nën hetime
  - o Kopje e pasaportës/dokumentit identifikues
- REKRUTIMI: **Vullnetarët ndërkombëtarë duhet të vlerësohen nga organizata që i dërgon ata** (siç është rasti me EVS). Duhet të kenë konfirmimin që nuk kanë kryer ndonjë vepër penale si dhe që nuk janë nën hetime. Vullnetarët ndërkombëtarë gjithashtu duhet të kenë vizë ose leje qëndrimi në mënyrë që të jenë vullnetarë në Kosovë dhe duhet të nënshkruajnë Rregulloren e TOKA--s për Mbrojtjen e Fëmijës
  - VIZITORËT: **Vizitorët dhe të tjerët** (domethënë gazetarët, fotografët, donatorët, partnerët etj.) që mund të jenë në kontakt me fëmijët, do të jenë të shoqëruar, në çdo kohë, nga një anëtar i stafit të TOKAs.

### 3. Rregullat e sjelljes/ Kodi i sjelljes

- RREGULLAT E SJELLJES/ KODI I SJELLJES: Si shtesë e trajnimit të stafit dhe në pajtim me rregulloret pedagogjike dhe ato të sigurisë, ne i përfshijmë fëmijët dhe të rinjtë si palë të interesuara në krijimin dhe mbështetjen e një mjedisi të sigurt. Kjo përfshin **përcaktim të përbashkët të rregullave dhe parimeve** të cilat fillimisht diskutohen mes pjesëmarrësve, pastaj miratohen dhe nënshkruhen në formë të kontratës grupore.
- RREGULLAT E SJELLJES/ KODI I SJELLJES: Për programet tona në të cilat pjesëmarrësit qëndrojnë për disa ditë/net në qendrën tonë, **ne kemi zbatuar rregullat kryesore të sigurisë** që përfshijnë: pas orës së mbylljes në kabina pjesëmarrësve nuk u lejohet të dalin nga kabinat (përveç në raste të urgjencës). Pjesëmarrësve nuk u lejohet ta kalojnë perimetrin e kampit pa leje nga edukatori i tyre. Në rast se pjesëmarrësi nuk i respekton këto rregulla, atëherë TOKA ka të drejtë ta përjashtojë nga kampi pas një vërejtjeje.

### 4. Edukimi/ Trajnimi

- TRAJNIMI: **Stafi i TOKA--s kalon nëpër një trajnim të detajuar dhe gjithëpërfshirës** që përfshinë aftësitë pedagogjike (si ta njohim dhe parandalojmë ngacmimin si dhe të gjitha format e tjera të abuzimit), ndihmën e parë dhe rregullat embrojtjes dhe sigurisë për programe të veçanta.
- TRAJNIMI: **I gjithë stafi, praktikantët, vullnetarët, partnerët, dhe të tjerët që do të jenë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës, do të trajnohen në Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijës** dhe do të kuptojnë se çka do të thotë abuzimi, standardet dhe procedurat e raportimit, dhe hapat që duhet ndërmarrë në lidhje me të.
- TRAJNIMI: **Stafi i TOKA--s do të trajnohet se si të silltet me vullnetarë nën moshën 18 vjeçare.** Trajnimi thekson faktin që ata janë ende të rinj dhe rëndësia e formave të ndryshme të abuzimit duhet njohur dhe kuptuar me kujdes. Për më tepër, reagimi ndaj çdo shqetësimi, dyshimi apo deklaratë për situata abuzive duhet të definohet qartë, të kuptohet dhe të pranohet.
- EDUKIMI I FËMIJËS: TOKA do të zhvillojë një procedurë raportuese e cila do të finalizohet deri në vitin 2020 dhe ka për qëllim që fëmijët të kuptojnë se si dhe te kush të raportojnë, nëse ata ose dikush që ata e njohin po keqtrajtohet apo abuzohet.

## 5. Zhvillimi i programit të sigurtë

- ZHVILLIMI I PROGRAMIT: Stafi ynë ka **vite të tëra eksperience në zhvillimin dhe implementimin e programeve edukative** në ambiente dhe popullata të ndryshme. Ne do të vazhdojmë të marrim mendime/komente dhe ndihmë të profesionistëve në krijimin e programeve të sigurta që e vazhdojnë traditën tonë të suksesit të lartë dhe normat e mbajtjes së këtij sukcesi.
- ZHVILLIMI I PROGRAMIT: TOKA mban ka përvojë **të suksesshme në udhëheqjen e edukimit përmes përvojës dhe projekteve në shërbim të komunitetit** me të rinj. Ne do të vazhdojmë të zhvillojmë projekte me të rinj duke përdorur vlerësimin, monitorimin e progresit dhe mendimet/komentet e palëve tona.

## 6. Komunikimi dhe kontakti privat me pjesëmarrës

- KOMUNIKIMI: Kjo Rregullore për Mbrojtjen e Fëmijës do të shpërndahet dhe të lexohet me të gjithë anëtarët e stafit, praktikantët, vullnetarët, partnerët, dhe të tjerët që do të jenë në kontakt me të rinjtë përmes TOKA--s, të cilët pastaj do ta nënshkruajnë në mënyrë që të tregojnë se pajtohen me atë se çka përmban kjo rregullore. Çdo shkelje çon në marrjen e masave të menjëhershme, siç është cekur në Raportimin/ Reagimin ndaj Shqetësimeve.
- KOMUNIKIMI: Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijës do tu tregohet të gjitha palëve të interesuara gjatë programeve të TOKA--s, dhe çdo shkelje do të çojë në marrjen e masave të menjëhershme, siç është cekur në Raportimin/ Reagimin ndaj Shqetësimeve.
- KOMUNIKIMI: Ndarja e shqetësimeve me palët që duhet të jenë në dijeni, si dhe përfshirja e përshtatshme e prindërve dhe fëmijëve-- zakonisht këshilltarëve të shkollës, profesionistëve ose mësuesve që janë përgjegjës për mirëqenien e nxënësve në klasë.
- UDHËZIMET: Vendosija e rregullave dhe pritshmërive të qarta në programet tona për stafin, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të rinjtë. Rregulla të cilat janë të caktuara në normën për "Vlerësim të Edukatorit" si dhe në kornizën për "Vlerësim të Performancës së Punëtorit".
- MEDIAT SOCIALE/KONTAKTE PRIVATE: Punonjësit, vullnetarët, përfaqësuesit dhe bashkëpunëtorët e TOKA-s nuk duhet të inicojnë miqësi private me të rinjtë përmes mediave sociale dhe shkëmbimit të detajeve të kontakteve private. Nëse pjesëmarrësi bën kërkesën për miqësi në mediat sociale - rekomandimi i TOKA-s është që të evitohet ky loj kontakti privat.

## 7. Përgjegjësitë e stafit menaxhues

- STAFI MENAXHUES: Siguron mbikëqyrje efektive për anëtarët e stafit, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të tjerët, përmes përkrahjes, drejtimit dhe trajnimit.
- STAFI MENAXHUES: I tërë stafi menaxhues do të japë mendime/komente mbi zbatimin e Rregullores së TOKA--s për Mbrojtjen e Fëmijës në "Rishqyrtimet e Vlerësimit të Performancës" së stafit që bëhen dy herë në vit. Çdo shkelje do të çojë në marrje të masave të menjëhershme, duke përfshirë edhe përjashtimin e stafit përkatës.

## 8. Implementimi dhe rishqyrtimi



IMPLEMENTIMI: Për të siguruar implementim të kësaj Rregulloreje TOKA do të:

1. **Trajnojë tërë stafin, praktikantët, vullnetarët, partnerët, dhe të tjerët që janë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës, në këtë rregullore**, duke i kushtuar vëmendje sidomos kuptimit të rëndësisë dhe formave të abuzimit. Niveli i trajnimit varet nga niveli i kontaktit që pritet ta kenë me fëmijë.
2. Sigurohet që **të gjitha palët e interesuara** të kenë njohuri mbi Rregulloren, duke përfshirë por duke mos u limituar në vendosjen e kësaj Rregulloreje në faqen tonë të internetit.
3. **Ndjekë procedurat e zvogëlimit të rrishtit** dhe uljes së gjasave të abuzimit.
4. **Punojë të krijojë një mjedis** ku stafi, praktikantët, vullnetarët, partnerët, dhe të tjerët që janë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës, të ndihen të lirë për t'i shprehur shqetësimet.
5. **Mbajë anonim** stafin, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të tjerët që janë të përfshirë.

RISHQYRTIM: Stafi përkatës, i udhëhequr nga Zyrtari Për Mbrojtjen e Fëmijës, do ta rishqyrtojë Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijës me mundësi rishikimi/ndryshimi çdo dy vite, në mënyrë që të sigurojë efikasitet të vazhdueshëm. I tërë stafi pastaj do të trajnohet në Rregullat e rishikuara/ndryshuara. **Mendime/Komente nga palët e interesuara** do të kërkohen në mënyrë që të sigurohet mbrojtje e të rinjve, stafit, partnerëve dhe donatorëve.

## 9. Të dhënat e prindit dhe leja për pjesëmarrje

TË DHËNAT E PRINDIT DHE LEJA PËR PJESËMARRJE: Për të marrë pjesë në programet e TOKA--s, ne sigurojmë një **pako me të dhëna** dhe dokumente për nënshkrim nga prindi. Gjithashtu, autorizimin, lejen për paraqitje në media dhe plotësimin e pyetësorit vlerësues, formën mjekësore në të cilën jepen shqetësimet mjekësore të pjesëmarrësit që duhet t'i dijë stafi, kontakte të urgjencës dhe autorizimin e TOKA--s të marrë hapa të nevojshëm të mbrojtjeje një të ri (nën moshën 18 vjeçare). Kjo siguron edhe përfshirje të prindit dhe informata të mjaftueshme për TOKA--n që t'i mbrojtë pjesëmarrësit.

# Siguria në internet

Ka disa gjëra që duhen marrë parasysh.

## 1. Rregullat themelore të organizatës:

- PRIVACI: Kontakti me fëmijët dhe kujdestarët e tyre për qëllime marketingu, ekspozimi në media, konsultim ose pjesëmarrje duhet të jetë me lejen e tyre të shkruar (përmes një formulari të autorizimit prindëror), dhe që nuk e shfrytëzon apo rrezikon fëmijën.
- PRIVACI: Menaxhmenti, punonjësit, vullnetarët dhe përfaqësuesit / partnerët e tjerë të TOKA, pa përjashtim, janë të detyruar të mbrojnë privatësinë e fëmijëve dhe anëtarëve të grupeve të cënueshme, në mënyrë që informacioni të mos jetë i disponueshëm për persona të tjerë, ose publikun.
- MEDIA SOCIALE: Informacioni personal i fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të grupeve të cënueshme në bazë të të cilave ata mund të identifikohen (d.m.th. etiketimi gjeografik, adresat, etj) nuk duhet të postohen në mediat sociale ose teknologjinë dixhitale.
- MEDIA SOCIALE: Punonjësit, vullnetarët, përfaqësuesit dhe bashkëpunëtorët e TOKA-s **nuk duhet të inicojnë miqësi private** me të rinjtë përmes mediave sociale dhe shkëmbimit të detajeve të kontakteve private. Nëse pjesëmarrësi i të rinjve fillon lidhjen me ta në mediat

sociale - rekomandimi i TOKA-s është që te përmbaheni nga komunikimi i drejtpërdrejtë individual.

## 2. Llojet e abuzimit në internet

Fëmijët dhe të rinjtë mund të përjetojnë disa lloje abuzimesh në internet:

- Bullying / cyberbullying
- abuzim emocional
- sexting (presion për të dërguar imazhe seksuale)
- abuzim seksual
- shfrytëzimi seksual

## 3. Shenjat identifikuese

Sinjalet që një i ri / e re që po përjeton abuzim mund të jenë:

- Duket të jetë gjithmonë në 'gjendje gatishmërie,' ansioz/e.
- Është i/e tërhequr në vete
- Ka vështirësi në gjumë, shpesh është i/e lodhur dhe duke u kotur
- Është vazhdimisht i/e brengosur se ka bërë diçka të gabuar
- Ka sjellje ekstreme, siç është të qenit tepër i/e dëgjueshëm ose tepër i/e insistues / agresiv
- Ka vështirësi në përqëndrim
- Abuzon alkoolit ose drogë
- Krijon tregimeve, poezive ose veprave artistike që përmbajnë dhunë
- Tregon pak interes për miqtë dhe aktivitetet
- Tregon mosbesim ndaj të tjerëve, veçanërisht të rriturve
- Ka problemet në të folur, psh belbëzim
- Thotë se ka dhimbje koke dhe dhimbje barky, pa ndonjë shkak të qartë
- I shmanget çdo lloj prekjeje ose kontakti fizik
- Ka vetëvlerësim të ulët
- Shfaq tendencë drejt depresionit
- Veshë tesha që nuk përputhen me motin - siç janë mëngët e gjata në ditët e nxehta - për të mbuluar lëndimet trupore.
- Nuk ka shpjegim të bindshëm për ndonjë lëndim, duke dhënë shpjegime që janë të paqartë ose të pabesueshme
- Shpreh mendime rreth vetëvrasjes, ose tenton vetëvrasje
- Nuk tregon dëshirë për t'u kthyer në shtëpi

Sinjalet që një i ri / e re që po përjeton abuzim **online** mund të jenë:

- harxhon shumë më tepër ose shumë më pak kohë sesa zakonisht, në internet, texting, lojra ose duke përdorur media sociale
- tërhiqet, shqetësohet ose zemërohet pasi që përdor internetin ose të shkruan tekst
- Mbanë fshehtësira se me kë po bisedojnë dhe çfarë po bëjnë në internet, ose në telefonin e tyre celular
- Ka shumë numra të rinj të telefonit, tekste ose adresa të emailit në telefonin, laptopin ose tabletin e tyre.

Një i ri / e re mund të **hezitojë të flasë** për abuzimet që ata janë duke përjetuar. Ata mund:

- mos ta kuptojnë që janë abuzuar
- ndjehem të turpëruar
- mund të fajësojnë veten për abuzimin
- nuk presin të marrin mbështetje nga familja, shkolla, shoqëria
- të kenë shumë siklet për të ndarë detajet seksuale të asaj që u ndodh atyre

- të kenë frikë për shkak të kërcënimeve të dhunës nga dhunuesi
- abuzuesi i ka bindur se nuk do të merren seriozisht
- kanë krijuar një lidhje emocionale me abuzuesin dhe nuk duan ta futin atë në telashe

## 4. Menaxhimi i situatës

Kur u përgjigjeni rasteve të abuzimit në internet, është e rëndësishme të kuptoni ndikimin që edukatori mund të ketë në mirëqenien e një personi të ri. Ai/ajo duhet:

- dëgjoni me qetësi atë që duhet të thotë personi
- mos harroni se i riu mund të jetë në siklet dhe / ose i turpëruar
- të mos gjykojë dhe të sigurohet që personi e di se abuzimi nuk është kurrë faji i tyre.
- të kontaktojë menaxherin e tij/saj, apo Nëpunësin e Siguriësë, për mbështetje.

Prindërit duhet të jenë të informuar në lidhje me rastet e abuzimit në internet përveç nëse me një veprim të tillë do ta vinin një fëmijë në rrezik të mëtejshëm të dëmtimit. Ata mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë për të kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe sa më mirë për të ndihmuar fëmijën e tyre.

# Procedura e raportimit dhe menaxhimit të rasteve

- **RAPORTIMI:** I gjithë stafi, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të tjerët që do të vijnë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës, kërkohet që menjëherë të raportojnë dyshimin për abuzim të fëmijëve tek mbikëqyrësi i tyre i drejtpërdrejtë dhe Zyrtari për Mbrojtjen e Fëmijës në TOKA. Nëse ndonjë staf dështon ta raportojë ndonjë rast, kjo do të rezultojë në trajnime shtesë dhe vlerësim të mëtejshëm.
- I gjithë stafi, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të tjerët që do të jenë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës udhëzohen t'i ndjekin hapat e mëposhtëm:
  1. Dëgjoni me kujdes dhe empati raportin e personit. Kërkoni nga ai / ajo lejen për ta inçizuar bisedën, e cila do të ndihmojë të mos humbni detajet e nevojshme për të plotësuar Formularin pas bisedës. Nëse ai / ajo nuk pranon, shkruani shënime të bisedës **menjëherë pas** bisedës.
  2. Komunikoni raportin / shqetësimet tuaja te menaxheri juaj, nëse ai / ajo nuk dyshohet te jetë i përfshirë në këtë rast. Nëse ai / ai dyshohet se është i përfshirë - shkoni direkt tek Zyrtari për Mbrojtjen e Fëmijëve.
  3. Plotësoni formularin e Raportit dhe jepni drejtpërdrejt Zyrtarit për Mbrojtjen e Fëmijëve.
  4. Kërkoni kujdes mjekësor për personin nëse është e nevojshme, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për të.
  5. Koordinoni me Zyrtarin për Mbrojtjen e Fëmijëve për të komunikuar me prindërit.
  6. Koordinoni me Zyrtarin për Mbrojtjen e Fëmijëve për të marrë lejen për ta referuar personin te instancat e shëndetit mendor, nëse është relevante.
  7. Nëse është e rëndësishme, Zyrtari për Mbrojtjen e Fëmijëve do të paraqesë një raport te Qendra për Punë Sociale ([informacionet e kontaktit që gjenden këtu](#)).

## Ilustrimi i Procedurës së Raportimit



- SIGURIA ËSHTË PRIORITET: Nëse një anëtar i stafit të TOKA (mbikëqyrës, Zyrtar për Mbrojtjen e Fëmijëve, Drejtor Ekzekutiv) **dyshohet për shkeljen e mbrojtjes së fëmijëve**, ju lutemi kontaktoni personin me pozitë më të lartë në organizatë që nuk është nën dyshimin në rastin përkatës. Nëse të domosdoshme, mund të kontaktoni Bordin e Drejtorëve të TOKA, kontaktet e të cilit janë renditur më poshtë:
  - o Anne Peymirat anne.peymirat@googlemail.com
  - o Arnaud le Masne de Chermont a.lemasne@gmail.com
  - o Ilir Hoxha a.lemasne@gmail.com
  - o Merita Gashi gashi.merita@gmail.com
- Nëse pjesëmarrësit ndihen të rrezikuar apo të trajtuar në mënyrë të padrejtë nga liderët e Klubit, ata mund të kontaktojnë stafin e TOKAs duke vizituar web-faqen e TOKAs në [www.toka-ks.org](http://www.toka-ks.org) dhe duke klikuar në kutinë **ASISTENCË PËR SUPER-VULLNETARË DHE SUPER-QYTETARË**. Forma e kompletuar do t'i shkojë automatikisht Zyrtares për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe **stafi i TOKAs do të kontaktojë brenda 24 orëve me ta**.
- MENAXHIMI I RASTEVE TË ABUZIMIT BRENDA ORGANIZATËS: Nëse stafi, praktikantët, vullnetarët, partnerët dhe të tjerët që kanë kontakt me të rinjtë përmes TOKAs dyshohen për një rast të abuzimit, atëherë Zyrtari për Mbrojtjen e Fëmijëve (me mbështetjen e Drejtorit Ekzekutiv) menjëherë do të njoftojë autoritetet përkatëse, në mënyrë që të fillojnë një hetim mbi rastin. Stafi i akuzuar do të suspendohet menjëherë, me pagesë deri në përfundimin e hetimit. Nëse konstatohet se ka kryer abuzim, stafi do të përjashtohet menjëherë. Nëse raporti vërtetohet si i rremë, stafi do të riintegohet në mjedisin e punës.

## Kodi i Sjelljes

Kodi ynë i sjelljes tregon pritshmëritë për të gjithë stafin, praktikantët, vullnetarët, partnerët, dhe të tjerët që janë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës, në sjelljet e tyre ndaj të rinjvedhe pjesëmarrësve të TOKAs.

Ne promovojmë liri të shprehjes dhe komunikim të hapur, por presim nga i gjithë stafi, praktikantët, vullnetarët, partnerët, dhe të tjerët që janë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës, ta ndjekin dhe respektojnë kodin e sjelljes.

### Këto rregulla vlejné për të gjithë stafin, pavarësisht nga kontrata e punës apo pozita.

1. Përdorimi i **duhanit, alkoholit apo substancave narkotike** në prezencë të të rinjve është i ndaluar. Stafi duhet të jetë i kthjellët gjatë gjithë kohës që punohet me pjesëmarrës të rinj.
2. **Sharjet, shakatë e papërshtatshme, bisedat intime** mbi jetën personale, dhe çdo lloj tjetër i ngacmimit në prezencë të të rinjve është i ndaluar.
3. **Vishuni përshtatshëm** për çdo aktivitet ose program. Veshja nuk duhet të jetë shumë e zbuluar dhe duhet të jetë e përshtatshme për aktivitetin në të cilin merrni pjesë.
4. I **trajtoni të gjithë të rinjtë me respekt**, pavarësisht gjinisë, racës, besimit, kulturës, gjendjes socio-ekonomike ose mungesës së aftësive. Dëgjoni në mënyrë aktive brengat dhe nevojat e tyre. Ne duam që të rinjtë tanë ta dinë që ne kujdesemi për ta dhe na interesojnë ndjenjat, interesat dhe zhvillimi i tyre.
5. Të gjithë që janë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës janë përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve dhe pjesëmarrësve në çdo kohë. Stafi asnjëherë **nuk duhet t'i lë të rinjtë pa mbikëqyrje. Qëndroni të angazhuar me ta gjatë gjithë programit**, duke biseduar me secilin individualisht për të parë se si po ndihen si dhe për t'i mbajtur të zënë me mësim dhe zhvillim.
6. Të gjithë që janë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës duhet te punojnë në **çifte**. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë **stafi duhet të vendoset aty ku të tjerët anëtarë të mund t'i shohin. Asnjëherë mos qëndroni vetëm me një fëmijë nën moshën 18 vjeçare**. Stafi, praktikantët dhe vullnetarët **nuk duhet të qëndrojnë natën në dhomë** me ndonjë pjesëmarrës.

7. Të gjithë që janë në kontakt me të rinjtë përmes organizatës **nuk duhet të abuzojnë** me të rinjtë në asnjë formë, duke përfshirë por duke mos u limituar në: abuzim fizik, seksual, emocional, ose mospërfillje. Asnjë lloj i abuzimit nuk do të tolerohet. Abuzimi do të jetë shkak për perjashtimit të menjëhershëm.
8. Stafit, praktikantët dhe vullnetarët duhet të **raportojnë te menaxhmenti** për anëtarët, praktikantët, vullnetarët, partnerët, ose të tjerët që shkelin ndonjëherë nga rregullat e shënuara në këtë kod të sjelljes.

**Organizata jonë do të ndërmarrë masa disiplinore për stafin ose vullnetarët të cilët vazhdimi i shkelin rregullat e shënuara në kodin e sjelljes.** Masat disiplinore do të ndërmerren varësisht nga shkelja. Pasoja të mundshme përfshijnë:

1. Vërejtje dhe përsëritje të trajnimit në kodin e sjelljes.
2. Ulje në pozitë dhe përsëritje të trajnimit në kodin e sjelljes.
3. Suspendim dhe përsëritje të trajnimit në kodin e sjelljes.
4. Ndërprerje të kontratës.

## Zyrtari për Mbrojtjen e Fëmijës (Safeguarding Officer) - Jehona Gjurgjeala

Një anëtar i stafit të TOKA--s që i është caktuar detyra për Mbrojtjen e Fëmijës, ka përgjegjësi shtesë në lidhje me sigurinë e të rinjve. Ky person do të mbështetet nga dhe do t'i raportojë drejtorit/reshës ekzekutiv/e. TOKA, tërë kohën, do ta ketë një person të caktuar për këtë detyrë (Shih seksionin -'Përshkrimi i punës për Zyrtarin Për Mbrojtjen e Fëmijës' ). **Për vitin 2020, ky person është Jehona Gjurgjeala.**

Kontakti i saj [jehona@toka-ks.org](mailto:jehona@toka-ks.org) | +383 48 825 520.

Përgjegjësitë:

1. Të kryejnë trajnime të përshtatshme për mbrojtjen e të rinjve në mënyrë që të sigurohen se janë në hap me kohën me njohuri mbi këtë temë.
2. Të jenë pikë kontakti për personat që kanë shqetësime në lidhje me mbrojtjen e të rinjve, të marrin të dhëna shtesë dhe t'i regjistrojnë ato shqetësime.
3. Të veprojnë mbi ato shqetësime në situata siç janë referimet në Qendrën për Punë Sociale ose në polici.
4. Të rishqyrtojnë planin vjetor të veprimit dhe Rregulloren e TOKA--s për Mbrojtjen e Fëmijës, me mbështetje të ekipit.
5. Monitorojë implementimin e kësaj rregulloreje.

# Çka duhet Të Bëni / Të Mos Bëni kur një i ri vendos të flasë mbi abuzimin

Nëse një i ri vendos të tregojë se është duke u abuzuar apo keqtrajtuar, ose nëse dyshohet që një i ri është në rrezik të abuzohet ose keqtrajtohet, i merrni parasysh veprimet në vijim:

TË BËNI	TË MOS BËNI
I ofroni mbështetje.	Mos krijoni panik.
Merrni me seriozitet gjithçka që thotë i riu.	Mos u vononi.
Rrini të qetë.	Mos premtoni të mbani të fshehta.
I bindni se kanë bërë gjënë e duhur që kanë vendosur t'i tregojnë dikujt.	Mos nxisni pyetjet që ju japin përgjigjen që ju dëshironi.
Përdorni gjuhë të kuptueshme për ta.	Mos u kërkoni ta përsërisin tregimin e ngjarjes pa nevojë.
I shpjegoni se çfarë do të ndodhë në vazhdim: që lideri i programit apo Zyrtari Për Mbrojtjen e Fëmijës duhet të informohet mbi abuzimin.	Mos shprehni ndonjë mendim mbi atë se çfarë ju kanë treguar.
Pyetni nëse mund ta inçizoni bisedën. Nëse nuk merrni leje, shenoni sa më shumë informata që ju kujtohen nga biseda <b>MENJËHERË</b> pasi që përfundon biseda me personin: duke përfshirë kohën, datën, vendin dhe çdo informate tjetër.  Ju mund të ftoni ata të kontaktojnë stafin e TOKAs duke klikuar në kutinë <b>ASISTENCË PËR SUPER-VULLNETARË DHE SUPER-QYTETARË</b> . Pasi që plotësohet raporti, <b>stafi i TOKAs do të kontaktojë brenda 24 orëve me ta.</b>	Mos merrni shenime të shumta gjatë bisedës; është më e rëndësishme që personi ndihet se po e dëgjoni me kujdes dhe empati - dhe se nuk janë nën hetim.
Ia kaloni raportin Liderit të Programit dhe Zyrtarit Për Mbrojtjen e Fëmijës.	Mos e diskutoni rastin me askënd tjetër përpos Liderit të Programit dhe Zyrtarit Për Mbrojtjen e Fëmijës. Mos filloni të hulumtoni më tutje vetëm.
Drejtoheni për mbështetje Zyrtarit për Mbrojtjen e Fëmijës, ose menaxherit juaj.	Mos e kontaktoni abuzuesin e supozuar.



# Formulari për Mbrojtjen e Fëmijës

**Hapat:** Shkruani përgjigjet në këtë formë, e shtypni dhe e nënshkruani atë, pastaj i'a jepni Zyrtarit Për Mbrojtjen e Fëmijës.

<b>Emri i fëmijës:</b>	
<b>Data e lindjes</b> (e fëmijës):	<b>Gjinia e fëmijës</b> (F/ M/ Tjetër):
<b>Numri i dokumentit të identifikimit të fëmijës:</b>	
<b>Koha, vendi, data ose informata tjera të rëndësishme:</b>	
<b>Shpjegim i shqetësimit mbi mbrojtjen e fëmijës</b> ( duke përfshirë ndonjë shenjë të dukshme ose lëndime tjera):	
<b>Vrojtime/ Informata tjera:</b>	
<b>Hapat e ndërmarrë:</b>	
<b>Emri:</b>	<b>Nënshkrimi:</b>
<b>Pozita:</b>	<b>Data:</b>

\*Nëse ka nevojë, ju lutemi kaloni në faqen tjetër, mirëpo sigurohuni që të jetë e bashkëngjitur me Formën për Mbrojtjen e Fëmijës.

Ju lutemi ta kaloni te Zyrtari Për Mbrojtjen e Fëmijës (Safeguarding Officer) në mënyrë konfidenciale/ private, menjëherë pas ngjarjes.



# Zyrtari për Mbrojtjen e Fëmijës

## Përshkrimi i detyrës

### Përshkrimi i organizatës

Qëllimi i TOKA--së është përshpejtimi i ndryshimeve shoqërore në Kosovë përmes investimit në rini.

### Përgjegjësitë

Të jetë pikë kontakti për persona të cilët kanë pyetje ose shqetësime në lidhje me mbrojtjen e të rinjve dhe të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme (p.sh. të bëjë referime të jashtme në Qendrën për Punë Sociale ose në Policinë e Kosovës).

Të monitorojë implementimin e Rregullores dhe procedurave të TOKA--s për Mbrojtjen e Fëmijës. Të përditësojnë politikat dhe procedurat me mbështetjen e stafit përmes rishikimit të përvitshëm të Planit të Veprimit mbi Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve të TOKA--s.

Të zbatojë rishqyrtimin e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijës dhe të përfundojë vetë auditimin çdo dy vite, duke filluar nga 1 Janar 2018.

Të trajnojë të gjithë stafin, praktikantët, vullnetarët, anëtarët e bordit, nëpunësit e rinj dhe të tjerët në TOKA në Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijës pas rishqyrtimit çdo dy vite, para punësimit/caktimit ose para nënshkrimit të kontratës.

Të trajnojë stafin në programe të veçanta në lidhje me çështjet e mbrojtjes së të rinjve siç janë të shënuara në Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijës.

Të ofroj trajnime bazike mbi Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve të TOKA--s për partnerët, vizitorët dhe të tjerët që do të jenë në kontakt me fëmijët përmes organizatës.

T'i formulojë dhe t'i mirëmbajë format e shqetësimeve për mbrojtjen e të rinjve, që janë forma konfidenciale dhe mbahen për referenca të TOKA--s.

T'i mirëmbajë dhe t'i rifreskojë të gjitha elementet e transparencës së TOKA--s të lidhura me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijës duke përfshirë mirëpo duke mos u limituar në afishe, rregullorenë faqen tonë të internetit, si dhe ndarjen e të dhënave me partnerët tanë.

Të jetë në hap me kohën sa i përket mbrojtjes së të rinjve, duke kërkuar mënyra të zhvillimit profesional të mëtejshëm në këtë temë dhe duke kontribuar në rritje të vetëdijesimit për këtë çështje në Kosovë.

Të ketë njohuri dhe të jetë i përfshirë në të gjitha çështjet e mbrojtjes së të rinjve në pajtim me donatorët.

### Kualifikimet

Të ketë njohuri mbi TOKA--n dhe historinë e saj në lidhje me mbrojtjen e të rinjve.

Të jetë i interesuar dhe i përkushtuar të ndihmojë TOKA--n të bëhet udhëheqëse e kësaj fushe në Kosovë.

Të jetë i organizuar dhe të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme komunikuese në gjuhën shqipe dhe angleze.

Të dijë të përdorë Microsoft Word--in, Excel--in dhe të komunikojë profesionalisht.

Të jetë i aftë dhe i gatshëm të lehtësojë trajnime dhe të punojë me grupe të njerëzve.

# Kontakte dhe Burime

## **Qendra për Punë Sociale**

Telefoni -- Zyra tek Qafa: 038/244 841

Telefoni -- Zyra tek Kodra e Trimave: 038/611--070 Telefoni -- Zyra tek Kodra e Diellit: 038/212--478 Adresa: Rr. UCK, nr 69/c, 10000, Prishtinë

## **Policia e Kosovës**

Zyra Regjionale në Prishtinë Linja fikse: 192 – 92038 550 999

Numër anonim: 080019999 Adresa: Rr. Luan Haradinaj p.n.

1000 Prishtinë, Republika e Kosovës

## **Zyra për Asistim dhe Mbështetje të Viktimave**

Zyra Regjionale në Prishtinë Shërbimi telefonik: 044/278--738 Numri zyrtar:

038/246--059

Adresa: Pallati i Drejtësisë, Ndërtesa e Prokurorisë Themelore,  
Aneksi C, Kati i Parë, Nr. i Zyres C007 and C006, Hajvali

Kjo rregullore është mbështetur nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, në parim dhe me udhëheqje të detajuar nga burimet standarde të rregulloreve online për mbrojtjen e fëmijëve. <https://www.unicef.org.uk/what-we-do/un-convention-child-rights/>

# Konfirmim i leximit dhe dakordimit

Deklaroj se nuk kam qenë kurrë objekt i ndonjë hetimi apo dënimi për sjellje të pahijshme ose abuzim të fëmijës. Unë konfirmoj se e kam kuptuar përmbajtjen e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe procedurave tjera të Organizatës Kosovare për Talent dhe Arsimit -- TOKA. Deklaroj se jam i/ e përkushtuar ta respektoj këtë rregullore.

Jam i/e informuar se në rast dyshimi për sjellje të pahijshme në kundërshtim me Rregulloren TOKA--s për Mbrojtjen e Fëmijës, organizata ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha masat administrative dhe ligjore, në pajtim me legjislacionin e brendshëm. Jam i/e informuar se në rast të shkeljes së kësaj rregulloreje, organizata ka të drejtë t'i informojë institucionet përkatëse. Nëse nuk i respektoj rregullat e shënuara në këtë Rregullore, unë marr përgjegjësi për pasojat, duke përfshirë edhe përjashtim të mundshëm nga TOKA.

*Ju lutemi t'i plotësoni detajet e mëposhtme dhe ta ktheni formën e kompletuar.*

Emri dhe mbiemri:

Numri i letërnjoftimit:

Nënshkrimi:

Vendi:

Data: